

VENDIM
Nr. 165, datë 27.3.2019

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM PARTISË REPUBLIKANE, SI SELI, TË DISA
MJEDISEVE TË GODINËS KATËRKATËSHE, TË ISH-SHTËPISË BOTUESE TË
LIBRIT SHKOLLOR “8 NËNTORI”, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të nenit 22, të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim Partisë Republikane, si seli, të disa mjediseve të katit të tretë, përkatësisht 6 (gjashtë) zyra në kahun verior të godinës katërkatëshe, të ish-shtëpisë botuese të librit shkollor “8 Nëntori”, sipas kartelës së pasurisë që i bashkëlidhet këtij vendimi, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
 2. Partisë Republikane i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.
 3. Vendimi nr. 534, datë 4.8.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për pajisjen me mjedise të Partisë Republikane”, shfuqizohet.
 4. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Edi Rama

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfqesues i familjes; B - bashkëpronar (%)

FORMULAR I AZHORNIMIT FUSHOR TE NJESIVE (TREGËTARE, PRODHUSE, etj.)

00002352

Zona Kadastrale B210 Nr i Pasurise Pallat 5/139 Ind. Hartes TB-P-8 Vol 9 Faqe 9
RRETHI TIRANE Q/ TIRANE Rr. M. GJOLLESHA P/G



Nr.	Nr. i njesisë	Emri i pronarit aktual	Emra të pronareve paraardhës (paraardhës, paraparaardhës, ...)	Shënime	
1	N ₁	JH.A. KOMBI	JH.A. GAJUPI - JH.TETI	$S = 70 m^2$	VP
2	N ₂	SHA MIRA 2H	JH.A. GAJUPI JH.TETI	$S = 111,0 m^2$	VP
3	N ₃	JH.A. GAJUPI	JH.A. GAJUPI JH.TETI	$S = 78 m^2$	VP.
4	N ₄	JH.A. KOMBI	JH.A. GAJUPI - JH.TETI	$S = 63 m^2$	VP
5	N ₅	JH.A. BOT. ENKLOPEDIKE	JH.A. GAJUPI - JH.TETI	$S = 40 m^2$	VP
6	N ₆	JH.A. GAJUPI	JH.A. GAJUPI - JH.TETI	$S = 100 m^2$	VP
7	N ₇	JH.A. MIRAZH	JH.A. GAJUPI JH.TETI	$S = 46 m^2$	VP
8	N ₈	JH.A. BOTIMET ENKLOPEDIKE	JH.A. GAJUPI - JH.TETI	$S = 92 m^2$	VP
9	N ₉	JH.A. BOT. ENKLOPEDIKE	JH.A. GAJUPI - JH.TETI	$S = 400,5 m^2$	VP
10	N ₁₀				VP

AZHORNIMI NE TERREN TOPOGRAF ARJANA GLAZHDANI DATE 26.3.2001